
	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA <b>KOMUNA E RAHOVECIT</b> OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

<b>Për:</b>	<b>Operatorë Ekonomik: ALFA DENT SHPK</b> me adresë në <b>Ferizaj</b> <b>Operatorëve Ekonomik</b> <b>Të gjitha palëve të interesuar</b>
<b>Nga:</b>	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës
<b>Datë:</b>	<b>08.11.2024</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **08.11.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **ALFA DENT SHPK** me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF-së**, me Numër të prokurimit: **623-24-11352-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-064-1-1-1**, nxjerr:

### VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **ALFA DENT SHPK**, me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF-së**, me Numër të prokurimit: **623-24-11352-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-064-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **30.10.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF-së**, me Numër të prokurimit: **623-24-11352-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-064-1-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **ALFA DENT SHPK**, me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF-së**, me Numër të prokurimit: **623-24-11352-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-064-1-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **30.10.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **08.11.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### BAZA LIGJORE E KËRKESËS

#### Pretendimi Ankimor me Nr. 1 i parashtruar nga OE:

AK-Komuna Rahovec ne aktivitetin e prokurimit te larteshenuar ka bere shkeljen e dispozitave ligjore duke e favorizuar nje operator ekonomik dhe duke diskriminuar shume OE te tjere duke vendosur kriteret diskriminuese, ku kjo ndikon ne uljen e konkurrences dhe njekohesisht edhe ne demtimin e buxhetit publik.

ANDAJ, ju si AK duhet ti hiqni kriteret diskriminuese, konkretisht Certifikaten ISO 13485-2016, e cila certifikate nuk e disponojne kompanite qe operojne me shitje te pajisjeve medicinale, por kjo ISO leshohet vetem per kompanite prodhuese, prandaj duhet te hiqet nga kriteri dhe nuk duhet te kerkohet nga Operoret Ekonomik, sepse te gjitha pajisjet medicinale se pari marrin leje nga AKPMM-ja dhe me pasjaj importohen ne Kosove, andaj kjo e deshmon se ky kriter eshte diskriminues sepse favorizon nje OE dhe diskriminon shume te tjere qe bie ne kundershtrim me nenin 7 te LPP-se (Barazia ne trajtim-mosdiskriminimi).

#### Përgjigjia e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 1:

##### **Pretendimi Ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr. 1 nuk qëndron;**

Autoriteti Kontraktues, këtë Aktivitet të Prokurimit e ka ndarë në katër (4) pjesë (lot) dhe përcaktimi i këtyre kriterëve, të këtyre kërkesave ka të bëjë lëndën së natyrës së tenderit në fjalë, dhe gjithashtu kërkesat të tillë janë të domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmimeve është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në pajtueshmëri me objektin e kontratës. **Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë** janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik

Autoriteti Kontraktues konsideron se kërkesa e AK-së janë relevante dhe proporcionale me natyrën e kësaj kontrate dhe kushteve/rrethanave reale që do hasen nga implementuesit e kontratës.

**Po ashtu sa i përket pretendimit tuaj Ankimor të parashtruar**, duke cekur: *ANDAJ, ju si AK duhet ti hiqni kriteret diskriminuese, konkretisht Certifikaten ISO 13485-2016, e cila certifikate nuk e disponojne kompanite qe operojne me shitje te pajisjeve medicinale, por kjo ISO leshohet vetem per kompanite prodhuese, prandaj duhet te hiqet nga kriteri dhe nuk duhet te kërkohet nga Operatoret Ekonomik, sepse te gjitha pajisjet medicinale se pari marrin leje nga AKPMM-ja dhe me pas jay importohen ne Kosove, andaj kjo e dëshmon se ky kriter është diskriminues sepse favorizon një OE dhe diskriminon shume te tjerë qe bie ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-se (Barazia ne trajtim-mos diskriminimi).*

**Me B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, i publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, me datë: 05.11.2024, kemi cekur:**

Vendi i tekstit i cili duhet të modifikohet:	Në vend të:	Është :
<b>Kapaciteti teknik dhe profesional</b>	<b>Kërkesa 5: Per LOT 1, 2 dhe 4 Operatori Ekonomik duhet të</b>	<b>Për këtë aktivitet te prokurimit nuk do të zbatohet,</b>

	<b>jetë i pajisur me këto Certifikata ISO ISO 9001-2015 (Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë); ISO 13485-2016 (Për Pajisje Mjekësore);</b>  <b>Dëshmia 5: Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali;</b>	<b>Kërkesa Nr. 5 e Kapaciteti teknik dhe profesional të Dosjes se Tenderit;</b>
--	--	---

Për këtë aktivitet të prokurimit nuk do të zbatohet, Kërkesa Nr. 5 e Kapacitetit teknik dhe profesional të Dosjes se tenderit, **Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;**

**Pretendimi Ankimor me Nr. 2 i parashtruar nga OE:**

Poashtu ne kriterin e dosjes nuk ka qene autorizimi, kurse me rastin e korrigjimit e keni futur edhe autorizimin nga prodhuesi

***Kërkesa per LOT 2: Për produktet e renditura ne pozicionin Nr. 65, 66 dhe 67, Prezantimi i produkteve te ofruara me katalogë/broshura; Dëshmia: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë tek AK katalogë/broshura nga prodhuesi i këtyre***

*furnizimeve për produkte e renditura ne pozicionin Nr. 65, 66 dhe 67, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike;*

*Kërkesa per LOT 2: Për produktet e renditura ne pozicionin Nr. 65, 66 dhe 67, Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi për shtijën e këtyre produkteve; Dëshmia: Te dëshmohet se Operatori është i Autorizuar nga Prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi për shtijën e këtyre produkteve, Autorizimi duhet te jetë me numër te prokurimit si me lart, (me te dhëna detaje te kontaktit për prodhuesin: adresa, websajti, numri i telefonit, emali);*

Kjo kerkese shtese eshte ne kundërshtim me dispozitat ligjore, konkretisht me nenin 7 te LPP-se, sepse nga nje kerkese per rishqyrtim eshte kerkuar te hiqen kriteret diskriminuese, kurse ju si ZPP nje kerkese e keni hequr dhe nje e keni shtuar e jo siq keni vepruar ju si Zyre e Prokurimit, ku keni vendosur kriter shtese.

Kjo vendosje e kriterëve kufizon konkurrencen dhe shihet haptazi qe ju si AK me keto kriterë po e favorizoni nje OE te caktuar dhe ky kriter favorizues duhet te hiqet ashtu siq e keni kerkuar ne kriter autorizimi i prodhuesit per pozicionet nr.65,66 dhe 67 se bashku me pershkrim dhe katalog.

Pra, duhet te hiqet kriteri i ri i vendosur ne korrigjim te procedures.

Pasi qe veprimet e tilla si Zyrtar i Prokurimit bien ne kundërshtim me dispozitat ligjore, kerkojme nga ju qe ta heqni kete kriter favorizues. Nese nuk do ta heqni do te na detyroni qe ne si OE ti drejtohem KRPP-se, OSHP-se dhe Organeve Hetuese per shkelje te ligjit qe po beni

## **Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2:**

**Pretendimi Ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr. 2 nuk qëndron;** Autoriteti Kontraktues, këtë Aktivitet të Prokurimit e ka ndarë në katër (4) pjesë (lot), për produktet e renditura ne pozicionin Nr. 65, 66 dhe 67 tek Lot 2 – **Furnizim me material reagensa shpenzues për Laborator**, është kërkuar **Katalogë/Broshura** nga prodhuesi i këtyre furnizimeve po ashtu është kërkuar **Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi për shtijën e këtyre produkteve**, për shkak të ndjeshmërisë të Pajisjeve të reja që janë në kuadër të QKMF-së, dhe analizave të cilat janë duke u punuar për herë të parë në Institucionin tona, ne e kemi parë të arsyeshme që të kërkojmë Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi, për të qenë të sigurt ne reagensa për këto tri (3) artikujt, që janë në rezultate për pacientet tanë.

Autoriteti Kontraktues ka dhënë mundësi për Operator Ekonomik potencial, që të prezantojë **Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi** për shtijën e këtyre produkteve, **Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;**

### **Pretendimi Ankimor me Nr. 3 i parashtruar nga OE:**

Poashtu vlen te potencohet se ju si AK keni perdor kriter favorizues si te kerkesa nr.2, qe kerkohet Licenca nga AKPMM-se, kurse te Deshmia kerkohet: **Dëshmia 2: Kopja e licencës valide nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM);**

**Kjo Licence eshte diskriminuese sepse kompanite qe merren me pajisje medicionale ku ne kuader te pajisjeve medicinale hyjne edhe materiali stomatologjik shpenzues, e qe Organi kompetent qe licencon kompanite siq eshte Agjencia e Kosoves per Produktet dhe Pajisjet Medicinale, per kompanite qe merren me shitje te pajisjete stomatologjike (medicinale), licencat i leshon per keto kompani vetem si Pajisje Medicinale, e jo per Produkte dhe Pajisje ashtu sic e keni kerkuar ju ANDAJ, kjo duhet te deshifrohet dhe te vendoset per LOT 1 - Licenca nga AKPPM per Pajisje Medicinale dhe te hiqet termi "produkte medicinale", per me teper mund te thirrni dhe ta verifikoni edhe ne organin kompetent qe i leshon keto licenca (AKPPM).**

**Andaj bazuar ne pretendimet tona te paraqitura si me larte kerkojme qe te merren parasysh dhe te korrighohen ashtu siq lejojne dispozitat ligjore e jo te favorizoni nje Operator Ekonomik dhe te diskriminoni shume OE te tjere, andaj kerkojme qe te hiqen dhe te korrighohen sipas dispozitave ligjore.**

Bazuar ne sqarimet e dhena si ne kete kerkese per rishqyrtim, ju si AK keni bere shkeljen e nenit 1 dhe 6 te LPP-se sepse ky favorizim ndikon qe te demtohet buxheti publik, andaj kjo nuk lejohet sipas nenit 7 te LPP-se, poashtu edhe te neni 69 - Kapaciteti Teknik dhe profesional keni kerkuar licenca jo adekuate, duke mos e bere dallimin sipas LOT-eve, por i keni perzier Licencat dhe e keni kerkuar te pergjithshme, sepse duhet te jete Licenca per Pajisje Medicinale, kurse ju e keni kerkuar Licencen per Produkte dhe Pajisje Medicinale, andaj kjo paraqet shkelje te dispozitave ligjore te LPP-se.

Poashtu vlen te potencohet se keni bere shkeljen e nenit 28 te LPP-se dhe nenin 19 te rregullores nr.01/2022 per Prokurim Publik, pasi qe edhe te specifikimi-pershkrimi i cmimit keni vendosur pershkrime jo adekuate per produktet e kerkuara, duke mos u kuptuar se pser cfare materiale shpenzuese behet fjale, andaj kerkojme qe ti korrighoni dhe

6/3

F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK

### **Përgjigja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 3:**

**Pretendimi Ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr. 3 nuk qëndron;**

Autoriteti Kontraktues, këtë Aktivitet të Prokurimit e ka ndarë në katër (4) pjesë (lot) dhe përcaktimi i këtyre kriterëve, të këtyre kërkesave ka të bëjë lëndën së natyrës së tenderit në fjalë, dhe gjithashtu kërkesat të tillë janë të domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmimeve është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi **në pajtueshmëri me objektin e kontratës**. **Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë** janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik

Autoriteti Kontraktues konsideron se kërkesa e AK-së janë relevante dhe proporcionale me natyrën e kësaj kontrate dhe kushteve/rrethanave reale që do hasen nga implementuesit e kontratës.

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), Nenin 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe profesional**, e kemi cekur:

#### **Kërkesa 2:**

**2.1. Per LOT 1, 2 dhe 4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) SI QARKULLUES ME SHUMICË PAJISJEVE MEDICINALE;**

**2.2. Per LOT 3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) SI QARKULLUES ME SHUMICË I PRODUKTEVE FARMACEUTIKE;**

**Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;**

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi të AK-së **ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

#### **Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi  
Menaxher i Zyrës se Prokurimit  
Komuna e Rahovecit